



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4589 prot.

Shkodër, me 24.02 .2025

## NJOFTIM

*Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak*

### **Të nderuar këshilltarë,**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, i ndryshuar njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën e **Hënë** datë **3 Mars 2025 ora.17:00**, me rend dite si më poshtë:

*Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 30.01.2025 sipas ligjit nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.*

1. *Pr/ Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Janar 2025”.*
2. *Pr/ Vendim: “Për strehimin emergjent të Znj.G.T dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira ( ish –Konvikti i Shkollës veterinare).*
3. *Pr/ Vendim: “Përditësim të VKK Bërdicë nr. 29, datë 06.05.2008 “ Për miratimin e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërdicë” të miratuar me VKM nr.895, datë 10.11.2010, “ Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bërdicë, të Qarkut të Shkodrës”, dhe inventarizimin e pasurisë me nr.383 volum 1, faqe 207 ZK 1157.*
4. *Pr/ Vendim: “Për miratimin e Kërkesës të shoqërisë trajtimi studentave sh.a për transferimin e pasurive me nr.2/204, nr.2/699, ZK 8593, pasurive me nr.3/733 dhe nr.3/957 ZK 8591”.*
5. *Pr/ Vendim: “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për licensimin e agjencive funerale/shtëpi funerale (Salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër”.*
6. *Pr/ Vendim: “Për një ndryshim në VKB nr.27 datë: 01.06.2016 „Për ngritjen e Këshillit artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve tij dhe miratimin e rregullores së financimit*

të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

7. Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak për vitin 2024.
8. Diskutime jashtë rendit të ditës.

### Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit	E Premte	28.02.2025	10:00
2.	Komisioni i Kulturës	E Premte	28.02.2025	10:30
3.	Komisioni i Çështjeve ligjore / Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike	E Premte	28.02.2025	11:00
4.	Komisioni i Planifikimit të Territorit.	E Premte	28.02.2025	11:30

Duke ju falënderuar,

KRYETAR

